



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	30. 05 2023	Ulli god Year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KSPN/HCV	4516/2023		1.5.2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.734/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.734/2023 të datës 15.05.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga pa numër në Prizren, kundër Vendimit të datës 19.04.2023 të Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.05.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.734/2023 e datës 15.05.2023 të parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi i datës 19.04.2023 i Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit.
- III. Mbetet në fuqi Vendimi i datës 06.04.2023 i Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit.

A r s y e t i m

Komuna e Prizrenit më datë 13.03.2023 ka shpallur njoftimin për publikimin e konkursit me Nr. Reference: RN00011192 për pozitën Zyrtar i Lartë për Teknologji Informativë, për lëvizje brenda kategorisë ku afati për aplikim ka qenë nga data 28.03.2023 deri më datë 04.04.2023. Në

këtë konkurs ka aplikuar ankuesi të cilit përmes Vendimit të datës 06.04.2023 të Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se ka bashkangjitur vetëm formularët e vlerësimit vjetor të vitit 2019 dhe 2020 dhe dokumentin për masë disiplinore të vitit 2021.

Ankuesi më datë 07.04.2023 ka parashtruar ankesë për Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit, ndërsa Menaxheri i Njësisisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Prizrenit më datë 19.04.2023 ka nxjerr Vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit të datës 19.04.2023, më datë 15.05.2023 nëpërmjet adresës zyrtare elektronike ankesa.kpmsk@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër protokollit 4236/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 17.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Prizrenit. Ndërsa Këshilli më datë 26.05.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4236/2023 e datës 15.05.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Konkursin me Nr. Reference: RN00011192 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Teknologji Informativë*, për lëvizje brenda kategorisë të shpallur më datë 13.03.2023 nga Komuna e Prizrenit; Dëshmi për aplikim e datës 31.03.2023; Vendimin e datës 06.04.2023 të Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit; Ankesën e datës 07.04.2023 e parashtruar nga ankuesi të Njësia e Burimeve Njerëzore; Vendimin i datës 19.04.2023 i Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 17.05.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 26.05.2023; Listën e aplikantëve; Vlerësim i datës 06.04.2023 dhe 19.04.2023 nga Menaxheri i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit; Aplikacionin e ankuesit i datës 31.03.2023; Diplomën me Nr. 112 e datës 07.01.1991; Shtojcën e Diplomës e datës 05.12.2003; Certifikatën e trajnimit maj 2021; Certifikatën për periudhën 24-26.01.2018; Certifikatën e trajnimit; Certifikatat e datës 25.02.2013; Certifikatën e trajnimit qershor 2009; Certifikatën e datës 10.08.2007, 07.06.2007; Certifikatën e trajnime mars 2012; Kontrata e punës e datës 01.01.2005; Akt Emërimit e datës 04.01.2012, 02.06.2015; Dokument identifikimi i ankuesit; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 06.01.2021 dhe datës 30.01.2020; Vërtetimin me Nr. 02-11678159/21 i datës 18.06.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është *e pa bazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 19.04.2023 të Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit, pretendon se provat e kërkuar në konkurs vlerësimet e rezultateve në punë për dy vitet e fundit janë në dosjen personale dhe Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prizrenit ka informata që këto janë në doje dhe ka informata që nuk kam masë disiplinore në fuqi dhe pa u konsultuar me dosjen time fizike më është refuzuar aplikacioni.

Bazuar në konkursin Nr. Reference: RN00011192 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Teknologji Informativë*, për lëvizje brenda kategorisë të shpallur më datë 13.03.2023 nga Komuna e Prizrenit, kërkesat e përgjithshëm formale kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të Kornizës Kombëtare të kualifikimeve (KKK) për profesione deficitare (TIK): Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakulteti i Elektroteknikës;*
- *Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Në këtë konkurs përkatësisht në pikën 5, dokumentet që duhet të paraqiten për aplikim ka qenë: *Kopje e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; Kopje e dëshmisë së punësimit; Kopje e dëshmisë së trajnimeve; Kopje e vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit; Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.*

Ankuesi me rastin e dorëzimit të aplikacionit për pozitën e cekur si më lartë në kuadër të dëshmimeve të lëndës ka dërguar dokumentet si: Diplomën me Nr. 112 e datës 07.01.1991; Shtojcën e Diplomës e datës 05.12.2003; Certifikatën e trajnimit maj 2021; Certifikatën për periudhën 24-26.01.2018; Certifikatën e trajnimit; Certifikatat e datës 25.02.2013; Certifikatën e trajnimit qershor 2009; Certifikatën e datës 10.08.2007, 07.06.2007; Certifikatën e trajnime mars 2012; Kontrata e punës e datës 01.01.2005; Akt Emërimit e datës 04.01.2012, 02.06.2015; Dokument identifikimi i ankuesit; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 datës 06.01.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 të datës 30.01.2020; Vërtetimin me Nr. 02-11678159/21 të datës 18.06.2021 për të konfirmuar se a ka masë disiplinore në fuqi apo jo.

Lidhur me kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizje brenda kategorisë, Kolegji i Këshillit ju referuar Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës të Kosovës, përkatësisht nenit 41 paragrafi 2, i cili përcakton se: "2.Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të

vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit", si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, bazuar në kërkesat e konkursit si në pikën 5 të tij si dhe bazuar në dokumentet e dorëzuar nga ana e ankuesit me rastin e aplikimit, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, dhe në bazë të vlerësimit të të gjitha provave, konstaton se ankuesi me rastin e aplikimit për pozitën Zyrtar i Lartë për Teknologji Informativ, nuk ka dorëzuar formularët e vlerësimit të rezultateve në punë respektivisht formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 dhe 2022, e të cilat kanë qenë kërkesa të konkursit dhe kërkesat e përcaktuar me dispozitat e cekura më lartë, ngase ka qenë obligim ligjor që kandidatët në procedurë duhet të dërgojnë formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për dy vitet e fundit në mënyrë që gjatë verifikimit paraprak Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të vlerësoj nëse kandidatët plotësojnë apo jo kushtet, rrjedhimisht në këtë rast ka qenë përgjegjësi e ankuesit të dërgoj dokumentet që kanë qenë të kërkuar sipas konkursit, ngase Njësia e Burimeve Njerëzore nuk është përgjegjëse të dërgoj dokumentet në emër të kandidateve në procedurë, sepse kur ankuesi ka mundur të dërgoj vlerësimet e rezultateve në punë për vitin 2019 dhe 2020 ka mundur që të dërgoj edhe vlerësimet e rezultateve në punë për dy vitet e fundit. Po ashtu Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi me rastin e aplikimit ka dorëzuar Vërtetimin me Nr. 02-11678159/21 të datës 18.06.2021 për të konfirmuar se a ka masë disiplinore në fuqi apo jo, ndërsa lidhur me këtë Kolegji konstaton se ky vërtetim nuk mbulon periudhën kohore të vitit 2023 në kohën kur është shpall konkursi pasi që nga momenti kur është nxjerr ky vërtetim kanë kaluar po thuajse dy vite, dhe ankuesi ka qenë i obliguar që të bëjë kërkesë për marrjen e një vërtetimi të ri nga Njësia e Burimeve Njerëzore me të cilën do të dëshmohet se nuk ka masë disiplinore në fuqi, ngase ka qenë kërkesë e konkursit dhe dispozitave të lartcekura.

Lidhur me pretendimet e ankuesit se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prizrenit pa u konsultuar me dosjen time fizike më është refuzuar aplikacioni, sepse ka çasje në bazë të Rregullores (MPB) Nr. 01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Kolegji i Këshillit, konstaton se kjo rregullore i referohet përditësimit të dosjeve personale të të punësuarve dhe çasja i lejohet Njesisë së Burimeve Njerëzore, por kjo nuk nënkupton se Njësia e Burimeve Njerëzore duhet të nxjerr dokumentacionet nga dosja personale e nëpunësit në këtë rast ankuesit dhe ti vendos në aplikacionin për konkurrim në pozita çoftë edhe të lëvizjes brenda kategorisë, ngase meqë konkurrimi në procedura të pranimit, lëvizjes brenda kategorisë apo ngritjes në detyrë bëhet përmes Sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (sistemit elektronik), siç parashihet me dispozitat e Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës të Kosovës, atëherë sipas Kolegjit sikurse është cekur më lartë kandidatët janë të obliguar që të dorëzojnë dokumentet në sistem që kërkohen me konkurs, në këtë rast ankuesi nuk i ka dorëzuar.

Nga të cekurat si më lartë, Kolegji i Këshillit, lidhur me ligjshmërinë e Vendimit të datës 06.04.2023 i Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit për refuzimin e aplikacionit të ankuesit me arsyetimin se ka bashkangjitur vetëm formularët e vlerësimit vjetor të vitit 2019 dhe 2020 dhe dokumentin për masë disiplinore të vitit 2021, konstaton se ky vendim është i drejtë dhe i ligjshëm sepse është nxjerr në pajtim me nenin 44

paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, paragrafi 2, nenin 45 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës të Kosovës, kështu që pretendimi i ankuesit se pa të drejtë i është refuzuar aplikacioni është pretendim i pabazuar.

Kolegji i Këshillit, lidhur me Vendimin të datës 19.04.2023 i Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit për refuzimin e ankesës së ankuesit, konstaton se arsyetimi i këtij vendimi përkon me Vendimin e datës 06.04.2023 të Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit, dhe në kuptim të vendosjes është i drejtë, mirëpo i njëjti është nxjerr jashtë afatit të përcaktuar me dispozitat e nenit 45 paragrafi 6 të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës të Kosovës, sepse *ankesa shiqyrtohet nga NJBNJ dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj*, si rrjedhojë ankesa e ankuesit është parashtruar më datë 07.04.20233 ndërsa vendimin është nxjerr më datë 19.04.2023, kështu që ky vendim nuk e ka ndryshuar aspak gjendjen faktike të rastit konkret.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.734/2023, datë 30.05.2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.